

RAPORTI I PUNËS PËR VITIN 2008

Viti 2008 do të kujtohet për arritje të rezultateve të mira, si në veprimtarinë bibliotekare, realizimin e shërbimeve, ashtu edhe në zhvillimin e aktiviteteve kulturore, që ishin të larmishme dhe të shumta. Shpresonim me të drejtë se edhe në këtë vit nuk do të mungojë mbështetja e Drejtorisë për Kulturë dhe Gjini e Komunës së Prishtinës për pasurimin e fondit të koleksioneve me libra të rinj, të përzgjedhur në bazë të projektit të bibliotekës dhe në bazë të kërkesave të përdoruesve, por kjo nuk u arrit përkundër përsëritjes së tenderit dy herë radhas dhe fituesit të dyfishtë të tenderit të shpallur nga Zyra e Prokurimit!... Kjo mund të ndikojë në vitin e ardhshëm në ngadalësimin e rritjes së numrit të përdoruesve. Në këtë raport janë paraqitur segmentet e veçantë të veprimtarisë bibliotekare dhe aktivitetit kulturor që janë zhvilluar gjatë vitit 2008 në bibliotekën ndërkomunale “Hivzi Sulejmani” të Prishtinës.

Punët profesionale

Përveç punëve profesionale si: përpunimi i librit, klasifikimi, katalogimi, printimi, puna me lexues etj., të cilat janë kryer në mënyrë profesionale, janë përpunuar të gjithë librat që kanë hyrë në bibliotekë gjatë këtij viti si dhe janë hartuar projekte për pasurimin e fondeve të bibliotekës dhe degëve të saj, janë mbledhur dhe hartuar raportet dhe planifikimet vjetore të punës që janë shqyrtuar dhe analizuar në Kolegjin profesional të bibliotekës dhe janë dhënë sugjerime e propozime për ngritjen e efikasitetit të punës.

Këtë vit për herë të parë biblioteka ka startuar me Programin për biblioteka ALEPH 500, gjegjësisht me modulën e katalogimit të cilin BKUK e ka shpërndarë falas në të gjitha bibliotekat ndërkomunale. Biblioteka ka filluar punën e katalogimit sipas këtij programi me sukses në tetor të vitit 2008 dhe ka kataloguar qindra njësi.

Puna e Kolegjit Profesional

Në çdo tre muaj janë shqyrtuar raportet periodike nga Kolegji Profesional i Bibliotekës dhe pas analizës së punës të çdo sektori e dege, janë dhënë vërejtje, sugjerime, këshilla, plotësime etj., me qëllim të ngritjes së efikasitetit dhe cilësisë së shërbimeve në raport me përdoruesit për dhënie të informacionit.

Koordinimi i punës me bibliotekat komunale

Me qëllim të përmirësimit të kushteve të punës dhe zhvillimit të veprimtarisë bibliotekare në bibliotekat komunale në Lypjan, Fushë Kosovë, Kastriot, Besianë dhe Drenas, mbikëqyrjen profesionale të të cilave, bazuar në Ligjin për biblioteka,

e ka për detyrë biblioteka jonë, gjatë këtij viti ka pasur kontakte, konsultime rreth punës profesionale dhe organizimit të sektorëve. Kantakte janë mbajtur edhe me qeveritë komunale të këtyre bibliotekave, si në Besianë, Drenas, Kastriot e Fushë Kosovë dhe është kërkuar prej tyre që të bëjnë më shumë për ato biblioteka në pasurimin e fondit të koleksioneve dhe në ngritjen profesionale të punonjësve dhe në renovimin e tyre.

Trajnimet

- Gjatë kësaj periudhe në bibliotekën tonë janë trajnuar për punë profesionale të bibliotekës katër punëtorë, dy prej të cilave sot janë të punësuar në BKUK dhe në Fakultetin e Kulturës Fizike. Ato morën njohuri të përgjithshme për punën me lexues, klasifikimin dhe katalogimin. Gjithashtu edhe material profesional që do t'u duhet në të ardhmen.
- Dy punëtorë të bibliotekës e patën një trajnim 8 ditor në BKUK për përvetësimin e punës në programin ALEPH 500.

Pasurimi dhe përtëritja e koleksioneve dhe periodikut

- Viti 2008 sa i përket pasurimit të bibliotekës me tituj të rinj, edhe në këtë vit nuk mungoi falë kursimeve të mjeteve të inkasuara nga anëtarësimi i lexuesve dhe dhurimit nga persona dashamirës dhe miq të bibliotekës. Por ka dështuar për këtë vit projekti i parashikuar për financim nga Drejtoria për Kulturë dhe Gjini e Komunës së Prishtinës që përmbante 250 tituj me 3264 kopje librash...
- Vlen të përmendet edhe shfrytëzimi i rastit gjatë mbajtjes së Panairit të Librit në maj të këtij viti në Prishtinë, ku Biblioteka bleu dhjetëra tituj dhe disa qindra libra për të pasuruar fondin e koleksioneve në vlerë prej 1850 € si dhe në Panairin e librit në Tiranë ku u ble një sasi e librave me vlerë 1150 €.
- Në këtë formë janë blerë edhe dhjetëra libra të tjerë nga autorë të vendit. Edhe institucione dhe individë i kanë dhuruar libra kësaj biblioteke. Në vitin 2008 kanë hyrë në bibliotekë gjithsej 538 tituj me 2827 kopje të librave. Prej tyre, libra të blerë 163 tituj me 1333 kopje dhe libra të dhuruar me 4968 tituj që bëjnë 1518 kopje.
- Gjithashtu furnizimi me periodik ishte i kënaqshëm. Në bibliotekën qendrore janë marrë gazeta të përditshme, të cilat u janë dhënë në shërbim lexuesve: "Koha ditore", "Zëri", "Epoka e re", "Lajmi", "Bota Sot", "Express", "Kosovarja", "Java"; radhës së revistave tashmë i është shtuar edhe revista letrare "Oaza" që e boton kjo bibliotekë. Sikurse viteve të tjera, u bë lidhja e tri gazetave ditore: "Bota sot", "Koha ditore", dhe "Zëri". Gazeta "Bota sot" një periudhë nuk është botuar, por tani del rregullisht. E marrim rregullisht falas revistën "Kosovarja".

Aktivitete bibliotekare dhe kulturore

- Në mars të këtij viti Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës realizoi një projekt shumë të rëndësishëm: shpërndarjen falas të një moduli të programit Aleph bibliotekave ndërkomunale. Ky program u instalua tek ne me 14 mars dhe u prezantua nga një ekip i BKUK. Biblioteka ka filluar katalogun elektronik me sukses në tetor të vitit 2008 dhe ka kataloguar 115 njësi.
- Java e bibliotekës në Kosovë (14-19 prill) është ngjarja më e rëndësishme nga bibliotekaria që mbahet në Kosovë. Gjatë kësaj jave pati ligjërata shumë të rëndësishme nga ekspertë të bibliotekarisë nga Amerika. Gjithashtu u organizuan aktivitete të shumta kulturore si: promovime librash, ekspozita, orë letrare etj. Gjithashtu gjatë javës së bibliotekës, me 17 prill, në Gjilan pati edhe një tryezë tematike nga bibliotekaria. Me kumtesa u paraqitën disa nga drejtorët e bibliotekave ndërkomunale të Kosovës.
- Me 20-22 nëntor u mbajt Konferenca kombëtare për bibliotekonomi në Tiranë, edicioni i tretë. Në këtë konferencë morën pjesë një grup bibliotekarësh nga Kosova, një pjesë e të cilëve u paraqitën me tema. Me temë nga biblioteka jonë u paraqit drejtori i bibliotekës Sylejman Pireva me temën : Bibliotekat publike përballë sfidave në procesin e ndryshimeve”. Tema e përgjithshme e këtij edicioni ishte: “Biblioteka- urë mes dijes dhe publikut”.
- Me 19-24 maj u mbajt panairi i Librit në Prishtinë. Biblioteka jonë e shfrytëzoi mundësin për pasurimin me tituj të rinj. U blenë 99 tituj me 586 ekzemplarë. Gjithashtu u bë projekti me vlerë 10 000 euro për pasurimin e bibliotekës me tituj të rinj të financuar nga Drejtorati për Arsimit dhe Kulturë të Komunës së Prishtinës.
- Me 16-19 nëntor një ekip i bibliotekës mori pjesë në Panairin e librit në Tiranë. Këtë projekt e financoi Drejtoria për Arsimit dhe Kulturë të Komunës së Prishtinës. Me këtë rast biblioteka me mjetet e veta bleu një sasi librash : 49 tituj, 411 ekzemplarë.
- Takimi i drejtorëve të bibliotekave ndërkomunale në BKUK për analizën dhe përgatitjen e projektit për financimin e Programit Aleph 500, disa nga modulet e tij.
- Pjesëmarrja në Sesionin shkencor me titull “Sistemi i integruar Aleph 500 në bibliotekat e Kosovës”, mbajtur më 04.09.2008.
- Takimi në MKRS me drejtorët e BKUK dhe bibliotekave ndërkomunale lidhur me financimin e Programit Aleph 500 dhe njoftimi me qëndrimin e MK për statusin e ardhshëm të këtyre bibliotekave.
- Në këtë vit u realizua edhe një projekt i rëndësishëm, siç është kyçja e internetit në degët: Biblioteka “Përrallat” dhe “Biblioteka Përkujtimore”.
- Këtë vit u mbajtën disa takime me krijues në degën „Biblioteka Përkujtimore“ dhe në degën „Përrallat“.
- Në degën “ Biblioteka Përkujtimore” RTK po realizon emisionin televiziv “Libër i hapur” . Këtë vit është bërë realizimi me sukses i disa emisioneve në bashkëpunim me punëtorët dhe lexuesit e kësaj biblioteke. Në këto emisione janë prezantuar veprat e shumë shkrimtarëve tonë të njohur. Kjo traditë do të vazhdojë edhe më tutje.

- Për nderë të festës së 7 marsit ditës së mësuesit dhe 8 marsit, ditës së gruas si zakonisht u përgatit një program i pasur në degën “Biblioteka Përkujtimore”. Lexuesit u paraqitën me punimet e tyre artistike dhe 3 më të mirët u shpërblyen me nga një libër.
E ftuar nderi ishte mësuesja veterane, zonja Heteme Mulaku, mësuese në shk. f. “Faik Konica” e cila foli para të pranishmëve për punën e saj shumëvjeçare në këtë profesion të shenjtë. Me këtë rast lexuesit kishin përgatitur një program të pasur kulturor. Edhe në degën “Përrallat gjithashtu u festua me nxënësit e sh. f. “Hasan Prishtina”, ku u lexuan krijimet e lexuesve dhe tri më të mirat u shpërblyen me nga një libër. Këto manifestime u përcollën me pika muzikore.
- Biblioteka Ndërkomunale “Hivzi Sylejmani” në bashkëpunim me Karvanin e shkrimtarëve, për herë të katërt, kremtoi 2 prillin, Ditën ndërkombëtare të librit për fëmijë e të rinj që u mbajt në degën “Biblioteka Përkujtimore”. Pjesëmarrës ishin Karvani i shkrimtarëve, njerëz nga kultura, prindër dhe lexuesit e bibliotekës. Hapjen e manifestimit e bëri drejtori i bibliotekës Ndërkomunale “H. Sulejmani”, Sulejman Pireva.
Në vazhdim u lexua mesazhi “ Librat janë dritë, dituria fal kënaqësitë” të cilin e ka shkruar për këtë vit C. Posaykrit. Fëmijët kishin përgatitur edhe pika të tjera në shënimin e kësaj feste, si këngë, vallëzim popullor, pika baleti. Një lexuese shprehu dëshirën pasi që ka prirje për të pikturuar, të punojë një punim artistik gjatë zhvillimit të programit.
Në bibliotekën Përkujtimore u shënuar 28 Nëntori, Dita e Flamurit, me lexuesit e bibliotekës. U lexua fjala e përgatitur për historinë e kësaj feste, si dhe punime të lexuesve kushtuar kësaj dite të rëndësishme dhe pati një program me këngë e valle.
- Me 10 qershor për herë të parë biblioteka jonë prezantoi para publikut ekspozitën me fotografi(120) nga punët dhe aktivitetet e bibliotekës të titulluar “Hapat e zhvillimit në vitet e lirisë” në kuadër të vitit të Pavarësisë së Kosovës. Kjo ekspozitë u ndoq me interesim të madh nga të pranishmit. Ekspozita qëndroi e hapur 3 ditë për publikun.
- Më 23 dhjetor u bë shpallja e lexuesve më të dalluar dhe e librave më të lexuar; u dhanë shpërblime për lexuesit më të mirë dhe mirënjohje për librat e dhuruar disa institucioneve dhe individëve; vlen të përmenden këtu Ambasada Turke, Instituti Albanologjik, BKUK, Karvani i Shkrimtarëve, kurse nga individët- Akil Koci, Agim Vinca, Ragip Sylaj etj.

Punët dhe shërbimet teknike (financiare, administrative, të furnizmit, mirëmbajtjes, rojës etj.)

- Janë punë të kryera brenda Sektorit të Financave dhe të administratës. Punët që kreu ky sektor janë ndër më të ndryshmet. Janë evidencuar të gjitha hyrje-daljet e mjeteve financiare, si nga anëtarësimi i lexuesve, ashtu edhe mjeteve të ndara nga Ministria e Kulturës dhe Komuna. U bë kalkulimi dhe regjistrimi i të gjitha

faturave hyrëse të këtyre mjeteve, është përgatitur Projekti buxhetor i Bibliotekës për vitin 2009 dhe raporti financiar në çdo tre muaj dhe është dërguar në Ministrinë e Kulturës.

- Janë evidencuar dhe sistemuar të gjitha dokumentat zyrtare. Është bërë furnizimi i të gjithë sektorëve dhe degëve me material bibliotekar dhe të pastrimit.
- Është intervenuar në raste të ndryshme për riparimin e defekteve të paraqitura dhe kujdesur për mirëmbajtjen e objektit të vjetëruar në të gjitha degët.
- Ky sektor është kujdesur edhe për mbajtjen e evidencës së përditshme të ardhjes në punë, si dhe pranimit dhe ruajtjes së dokumentacionit nga pushimet vjetore dhe mjekësore.
- Ky Sektor është kujdesur edhe për punën e pastrimit të objektit të bibliotekës dhe të degëve të saj.
- Është bërë regjistrimi i invenarit dhe pronës së Bibliotekës nga komisioni i caktuar nga ana e drejtorit të bibliotekës dhe është dërguar një kopje në MKRS dhe një në Komunë.

Aktiviteti i Klubit të Letrarëve të Rinj “Prishtina” të Bibliotekës

- Me 22 prill biblioteka ndërkomunale “H. Sylejmani” bëri shpalljen e rezultateve të konkursit letrar, festoi 5 vjetorin e themelimit të Klubit Letrar “Prishtina” dhe shënoi Ditën Ndërkombëtare të librit. U dhanë nga katër shpërblime nga zhanret e ndryshme letrare: poezi, prozë, dramë dhe ese.
- Me 9 tetor u mbajt një Tribunë përkujtimore me rastin e 70 vjetorit të vdekjes së Migjenit. Kjo tribunë u organizua nga Klubi Letrar “Prishtina” dhe biblioteka ndërkomunale “Hivzi Sylejmani” në Prishtinë. Me tema profesionale për veprimtarinë e Migjenit u paraqitën: Agim Vinca, Sylejman Pireva, Gëzim Aliu, Ag Apolloni Adil Olluri.
- Pjesëmarrja e anëtarëve të KL “Prishtina në jurinë e Manifestimit letrar ballkanik “Elira” që u mbajt në Fushë Kosovë.

Botimet:

- Novela e autorit Safet Hasni “Pranvera e lirisë”
- Dolën 2 numra të revistës letrare “Oaza”

Promovimet:

- Me 13 mars 2008, në ambientin e bibliotekës u promovua libri “Pranvera e lirisë” i autorit Safet Hasani. Libri është botim i bibliotekës ndërkomunale “Hivzi Sylejmani” .

Ekspozitat:

- Herë pa herë ka pasur ekspozita të punimeve të lexuesve në degët e bibliotekave ku punohet me fëmijë, të cilat janë ekspozuar në ambientet e bibliotekës.
- Më 23 dhjetor u hap ekspozita e titujve të librave të rinj të vitit 2008.

Renovimet dhe pajisja me inventar

- Është bërë renovimi i platosë së oborrit dhe trotuarit të Bibliotekës qendrore, sipas projektit të përgatitur nga kjo bibliotekë dhe përmes rrugës së tenderimit të shpallur nga zyra e Prokurimit të MK; punimet zgjatur 10 ditë, por janë humbur vetëm 3 ditë pune, ngase ato u kryen gjatë ditëve të festës të muajit maj; projekti u financua nga të hyrat e Bibliotekës;
- Para përfundimit të muajit dhjetor u krye renovimi tjetër i aneksit të bibliotekës (sallës së leximit, tualeteve dhe korridorit), gjithashtu financuar me të hyrat e brendshme të Bibliotekës;
- Është përgatitur projekti tjetër për renovim të objektit të “Bibliotekës Përkujtimore” dhe është konkurruar në Raiffeissen bank, por që nuk u realizua, pasi që kjo bankë nuk e mori para sysh.
- Këtë vit nuk ka pasur pajisje me inventar të ri.

**Prishtinë,
02 dhjetor 2008**

**Drejtori,
Sylejman Pireva**